



**KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË**  
SKUPŠTINA OPŠTINE - SUVA REKA  
MUNICIPALITY OF SUHAREKA



**PROCESVERBAL VI/2024**

**I mbajtur me rastin e mbledhjes së 6 (gjashtë) për vitin 2024 të Kuvendit të Komunës së Suharekës**

---

Vendi: Suharekë  
Zyra: Salla e Kuvendit të Komunës  
Data: 27.06.2024  
Ora: 10.00

---

**Prezentë në takim:**

Z. Shefket Kolgeci  
Z.Selman Kolgeci  
Z. Flamur Bytyqi  
Z. Urim Suka  
Z. Kushtrim Kuçi  
Znj. Elmaze Bytyqi  
Znj. Bulëza Kuçi  
Znj.Doruntina Zenelaj  
Z.Alban Berisha  
Z. Bexhet Kuçi  
Z. Reshat Selimaj  
Z. Lirim Qatani  
Z. Aziz Bytyqi  
Znj.Sanie Kuçi-  
Rexhepaj  
Znj.Fidaije Kukaj

Znj. Afërdita Morina  
Z. Vullnet Luzhnica  
Z. Xhevshet Gashi  
Z.Edon Sadikaj  
Znj.Saranda  
Bajraktari  
Znj.Mimoza Bajraktari  
Znj.Festë Kabashi  
Z.Dardan Berisha  
Z.Bajram Basha  
Znj.Mevlude Kabashi  
Znj.Sheqerije Zyrapi  
Znj.Laureta Tafaj  
Z.Liridon Fandaj  
Z.Qëndrim Elshani  
Z.Herolind Limaj  
Znj. Jehona Rrafshi

**Të pranishëm të tjerë**

Kryetari Komunës  
Media dhe qytetarë  
OSCE, LMT, KDI  
Znj.Habibe Bytyqi  
Z.Xheladin Sadikaj

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi,i cili propozoi këtë:

### **REND DITE**

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e kornizës afatmesme buxhetore për Komunën e Suharekës për vitin 2025-2027;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për caktimin e vlerës së bonus banimit;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishtëm për “Fshatin Rekreativ-Turistik në Delloc”;**
- 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajshme të Komunës;**
- 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e kërkesës 01-Nr-181-30362;**
- 7. Pyetje dhe përgjigje;**

**Dardan Berisha** - kërkoj që të futet edhe një pikë shtesë në rend dite në lidhje me kërkesat e FC Suharekës për shfrytëzimin e fushës ose terenit sportiv.Unë nuk kërkoj të shkëputet kontrata por dua ta ngris si shqetësim që ne si kuvend me gjet një zgjidhje për të dy klubet.E kam të qartë kontratën dhe nenin i cili ia mundëson shfrytëzimin e terenit sportiv por unë dua ta ngris si pikë të rendit të ditës që të diskutohet edhe nga gjithë kolegët asambleistë për me gjet një zgjidhje sa më të mirë për të dy klubet.

**Kryesuesi** - ne e kemi bisedu edhe në KPF se si ka rrjedh procedura dhe faktikisht iu kam dërgu edhe juve një shkresë që ia kam kthyer përgjigjen klubit FC Suhareka.Është e vërtetë që klubi FC Suhareka i ka adresu dy kërkesa zyrës së Kuvendit mirëpo njëra kërkesë më ka ardhë dhe njëra jo për shkak të gabimit teknik që e kanë bërë ata.Kërkesa është bërë me 14.06.2024 dhe unë përgjigjen ia kam kthyer me datë 18.06.2024 në formë elektronike por edhe me kopje fizike ku e kemi informuar se si është situata me stadiumin,që në këtë rast kuvendi nuk ka kompetenca me ndërpre një kontratë ose me vazhdu një kontratë.Kryesuesi lexon përgjigjen që i është kthyer FC Suharekës.

**Dardan Berisha** - nëse i referohemi kontratës,kjo kontratë është dashtë të shkëputet më herët.Ne i dimë obligimet.Unë nuk e ngrita çështjen e kontratës por unë e ngrita një diskutim për me gjet një zgjidhje.Lexon kërkesën e Ekrem Sadikut (FC Suhareka) ku në fund të kërkesës thuhet: nëse kërkesa jonë nuk merret seriozisht dhe në mënyrë të shpejtë,FC Suhareka do të ndërmerr hapa më rigoroz,përfshirë protesta dhe veprime tjera ligjore për të siguruar që të drejtat tona të njihen dhe të respektohen si duhet.Ne këtë po duam ta ndalim dhe të gjejmë një zgjidhje ndërmjet dy klubeve.Nëse i referohemi kontratës FC Ballkani e ka edhe me investu.Ai ka bërë zero investime dhe të gjitha ato investime aty janë falas,edhe bari është prej FFK-së.

**Vullnet Luzhnica** - është mirë me gjet zgjidhje mes dy klubeve por FFK-ja e ka me ligj detyrën e investimeve.Është mirë me pas një interpretim ligjor të saktë për të dy palët dhe me ngrit këtë çështje.Neve nuk na takon me dal jashtë kompetencave tona.

**Urim Suka** - diskutimi ishte vetëm për me hap pikë të rendit të ditës dhe me diskutu por ne filluam me diskutu dhe dolëm prej atij propozimi.Është mirë propozimi me hy në pikë të rendit të ditës dhe nëse hyn me diskutu.Situata e krijuar mbas krijimit të klubit Suhareka është një situatë e re.Kur kontrata është bërë,nuk ka qenë një klub i ri.Ne dime që Ballkani i ka të gjitha të drejtat me menaxhu me stadiumin sepse e ka një kontratë që ia ka dhënë Kuvendi me procedurat si kanë shku.Nuk jemi për me ia marrë ato të

drejta sepse është një klub që është kampion dhe ka me na përfaqësu.Me diskutu mundemi por me vendos nuk mundemi dhe i japim mbështetje për me diskutu.

**Liridon Fandaj** - unë e mbështes Dardanin për atë që kërkoi.Nëse ne si Asamble nuk mundemi me vendos,këtij iu ka bo kontrata dhe ka vendos kjo Asamble dhe ata nuk kanë kërku prej neve me ia shkëput kontratën por ata kanë kërku me diskutu dhe me ju mundësu që me i kry ushtrimet.Nuk i jepet një e drejtë Ballkanit me ia caktu kur të do oraret dhe hiq më pak që nenin 3 të kontratës e kanë shkel.Çdo nen që shkelet kontrata është e pavlefshme dhe e obligon ekzekutivin konkretisht Kryetarin me shkëput kontratën.Unë kërkoj që stadiumi me u marrë në kuadër të Drejtorisë së Kulturës dhe secilit klub me ia mundësu dhe me ia bë orarin për ushtrime.

**Aziz Bytyqi** - jam dakord me Urimin.Çështja ishte për tu fut në pikë të rendit të ditës dhe ne e diskutuam ende pa hy në rend dite.Ne mund ta shprehim shqetësimin dhe me iu bë thirrje klubeve që të merren vesh.Kur është kriju kontrata ajo që thanë kolegët është saktë që kjo nuk ka ekzistuar dhe ne e kemi vullnetin e mirë për me diskutu këtë çështje.

**Dardan Berisha** - unë desha të ndalem vetëm te paragrafi i fundit.Nëse ne kemi gjet zgjidhje të shumta këtu, mundemi me gjet një zgjidhje sepse ka jurista shumë më të zotët se ne këtu,me gjet një zgjidhje dhe me nxjerr një akt nënligjor ose të ulemi dhe të diskutojmë.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën shtesë në rend dite për diskutim.

**Unanimisht Miratohet**

**Kryesuesi** - e hedh në votim rendin e ditës me pikën shtesë.

**Unanimisht Miratohet**

**Pika 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kalura;**

**Kryesuesi** - e hedh në votim pike 1.

**29 për, Miratohet Pika 1**

**Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e kornizës afatmesme buxhetore për Komunën e Suharekës për vitin 2025-2027;**

**Kryesuesi** - e elaboron pikën dhe hap debatin.

**Urim Suka** - kur jemi në diskutimin për kornizën afatmesme buxhetore si një nga dokumentet kryesore që ky kuvend merr,unë kam bërë përpjekje që ti kushtoj vëmendje maksimale në fjalën time që do të mbaj sot para jush me qëllim të argumentimit të gjithë atyre që do të japim sot.Kur e sheh këtë dokument e shesh se sa keq është i përgaditur dhe se sa me pa përgjegjësi na ofrohet neve për me miratu një dokument të tillë.Para një viti është sjell një dokument kornizë ku të paktën janë parapa disa rrugë me emra dhe të paktën ka qenë më konkret edhe pse ka pas shumë probleme që ne i kemi thënë atëherë.Në këtë dokument që e kanë sjell vetëm shkruan rrugë lokale dhe është gjynah me pa dhe me miratu në formën si na ka ardhë.Ekzekutivi për me përgadit këtë dokument i ka dërgu ftesë kryetarëve të fshatrave për me i dhënë propozimet e tyre.Kryetarët e fshatrave,të paktën unë e di për Bllacë çka ka ndodh,i kanë ftu kryesitë e fshatrave me të gjitha partitë dhe ata i kanë shkruar emrat konkret të rrugëve,e kanë protokoluar në komunë dhe asnjë propozim i tyre nuk figuron në kornizë.Përgjegjësi e tyre është me mbajtë diskutime publike.Në diskutime publike i kanë ftu qytetarët në secilin vendbanim dhe ata pak qytetare që kanë ardhë,i kanë dhënë propozimet e veta dhe kur ka ardhë korniza te ne,shkruan vetëm rrugë lokale për secilin fshat.Në diskutimin publik që u mbajt në qytet neve materiali na ka ardhë paradite nëse nuk gaboj ndërsa diskutimi publik në Suharekë është mbajtë pasdite.Shqetësim tjetër është që herave të tjera para se me ardhë kjo kornizë janë ftu anëtarët e KPF-së për të diskutuar paraprakisht dhe zakonisht iu kemi përgjigj kësaj ftese dhe e kemi dhënë kontributin tonë por këtë vit nuk na ka thirr askush për me diskutu paraprakisht pa ardhë këtu.Në këtë kornizë shkruan: Instalimi dhe sanimi i ndriçimeve publike në fshatra

dhe qytet 300.000€ për vitin 2025. A nuk është më mirë që ky ekzekutiv me i parapa këto ndriçime publike se ku do mi qu? Gjendja me ndriçime publike është katastrof sa çdo vit planifikohet në këtë formë. Projekti: Ndërtimi dhe rikonstruimi i kanalizimeve në komunë është 400.000€. A s'mujna me specifiku se në cilin fshat po don me bë këtë kanalizim, në cilën lagje në qytet, në cilin vend? Çdo vit nga 400.000€ e 500.000 € në këtë formë planifikohen pa e ditë se ku po shkojnë dhe vërtetë është e pa përgjegjshme dhe unë lus që mos ti japim mbështetje por ta përmirësojmë si dokument. Ndërtimi i urave në fshatra dhe komunë 100.000€: A është shumë zor ekzekutivi me gjithë atë infrastrukture që e ka, me dal dhe mi pa cilat ura kemi me i shtrë? Ndërtimi i impianteve për ujërat e zeza Sllapuzhan-Dubravë 100.000€ +100.000€. Vitin e kaluar ne e kemi votu një buxhet që sivjet nga 90.000€ janë nda për këto impiante por kornizën e kemi votu vitin e kaluar janë parapa 200.000€ për vitin 2025. Dua ta di, a ke fillu me këto impiante, pse tash vetëm 100.000€ dhe a do të kryhen vitin e ardhshëm apo si do të shkoj puna me këto impiante? Ndërtimi i objektit të komunës 20.000€ dhe ndërtimi i shkollës "7 Marsi" 112.000€. Prej se kemi hy në Asamble çdo vit na vjen si planifikim dhe asnjë ditë nuk ka ndodh investimi por unë uroj që të bëhet shkolla "7 Marsi" sepse ka nevojë. Dua ti ngris disa shqetësime për fshatin Bllacë. Për ujësjellësin në Bllacë vitin e kaluar është bë një investim dhe më herët një investim tjetër dhe afërsisht 30-40% e vendbanimit ka ujë por as këtë vit nuk ka planifikim dhe as për vitet e ardhshme në Bllacë nuk po planifikohet m'u bo diçka për ujësjellësin. A mundeni diçka me planifiku me që edhe pjesa tjetër ka mbet sepse premtimi ka qenë para 7 vjete që Bllacën kemi me bë me ujë. Shtrati i lumit është mirë me u rregullu dhe sa e di edhe kryesia e fshatit ka bë kërkesë. Impianti i ujërave të zeza mirë nëse ka fillu në Dubravë dhe Sllapuzhan por Bllaca është edhe vendbanim i madh dhe gjendja është alarmante dhe këtu nuk po shoh që është planifiku. Në Bllacë problemet me kanalizime dhe ndriçime vazhdojnë me qenë të mëdhaja dhe përkundër investimeve që keni provu me i bë. Është premtu qerdhja në Bllacë dhe askund nuk shihet në këtë kornizë. Hapësira për varreza është emergjente dhe duhet urgjentisht në këtë kornizë me parapa një buxhet simbolik që pak a shumë e rregullon. Disa qytetar na kanë kërku vendosjen e shtatorës së Ram Bllacës te shkolla "Ram Bllaca" dhe është mirë të vendoset busti i Ram Bllacës. Një kërkesë që m'ka ardhë së fundi nga qytetarët duke marrë shkas nga Pagarusha, që e kanë bë Nexhmie Pagarushën. Ne e kemi revynë e rapsodëve Riza Bllaca që e mbajmë çdo vit dhe Drejtoria e Kulturës është mirë me parapa një shtatore ose bust të Riza Bllacës me ndërtu në ndonjë shesh të Bllacës sepse e dimë kontributin e Riza Bllacës. Kolegë të nderuar asambleist, nuk e kam për me bë një lloj kritike dhe për me rrëzu një dokument apo me miratu një dokument dhe ju mund të vendosni si të doni por mënyra si na ka ardhë ky dokument është e turpshme me qu dorën përpara. Mos ta votojmë sot dhe mbas dy dite nëse e ndryshojnë këtë dokument edhe unë po e qoj dorën për. Sot mos ta votojmë, le ti marrin kërkesat e kryetarëve të fshatrave që i kanë protokolu dhe i kanë sjell dhe kërkesat e banorëve që kanë mbajtë diskutime publike dhe le ti vendosim këtu dhe edhe ne e votojmë.

**Laureta Tafaj** - Kryetar si çdo vit edhe këtë vit kjo kornizë është vetëm në interesin e juaj personal e jo në interesin e qytetarëve. Ju sot po kërkon votën tonë për këtë kornizë e nuk keni qenë në gjendje të paktën një javë përpara me na thirrë dhe me diskutu bashkë me neve dhe kurgjë nuk ju kish kushtu. Në dëgjimet publike me qytetarë keni dështu, e keni pa edhe vet. Edhe ata janë lodh sepse çdo vit tu shku e duke mos u marr parasysh asnjë kërkesë e tyre. Te Shërbimet Publike: Ndërtimi i rrugëve lokale, e keni ndërru pak sepse para një kohe e keni pas: Ndërtimi i rrugëve lokale etj. Te Administrata dhe personeli, ku mbet ai objekt i Kuvendit Komunal? Sa herë del kuvendi komunal dhe ne askund nuk po e shohim. Te shkolla "7 Marsi", çfarë projekti keni fillu me 112.000€ kur ka njerëz që një shtëpi nuk mund ta bëjnë me 112.000€, ju një shkollë midis qytetit.

**Selman Kolgeci** - sigurisht që ky projektion buxhetor do të duhej të ishte i ndërtuar mbi rezultatet që kanë dal nga dëgjimet publike dhe ajo që më intereson është që: a ka procesverbale për këto takime publike dhe sa ka qenë pjesmarrja e qytetarëve në takimet për ndarje të buxhetit? A është mbajtë dëgjim publik në secilin fshat dhe sa ka qenë niveli i informimit nga ana e komunës në lidhje me dëgjimet buxhetore për fshatrat e komunës tonë dhe qytetit tonë? Mbi cilin kriter i keni nda mjetet për rrugët të cilat janë pjesë e këtij projekcioni buxhetor, a dihet gjatësia e tyre, a dihet cilat pozicione kanë me u realizu dhe mbi bazën e kujt i keni nda këto mjete? Shqetësim tjetër është emërtimi ku në secilin fshat e keni shënu rrugë lokale. Cilat janë ato rrugë lokale? A janë rrugë publike, a janë rrugë e oborreve private? Ju

duke i pas emërtimeve të rrugëve, duke i pas ndarjet buxhetore e duke i pas kontratat me emra të caktuar për secilin fshat, prap se prap nga praktikatat e viteve të kaluara i keni tejkalu të gjitha këto dhe keni rregullu oborre private me para publike. Nëse ka pas dëgjime publike nuk po e kuptoj si në asnjë fshat nuk dol asnjë qytetar me thënë që ky është emri i rrugës që duhet me u ndërtu. Nëse ka pas të tillë, pse nuk e keni përfshi në këtë projektion buxhetor dhe pse i keni kalu diskutimet publike vetëm si formalitet. Sa i përket fshatit Vraniq, ne e kemi diskutu disa herë nevojën e investimit në parcellën e ndarë nga kuvendi komunal për varrezat e fshatit Vraniq dhe po e shoh që nuk e keni parapa në këtë kornizë asnjë euro për këtë çështje. Investim tjetër i nevojshëm që e kemi diskutu edhe më herët është edhe investimi në kaptazhat e ujit, ku një sasi e madhe e ujit nuk hyn fare në kaptazha. Te instalimi i ndriçimeve publike në fshatra dhe qytet i keni planifiku 912.217€ për vitin 2025-2026-2027 dhe më intereson të dijë saktësisht në cilin lokalitet e keni planifiku këtë zgjerim të ndriçimit? Dua ta pyes Kryetarin sa është realizu kontrata e ndriçimit eficient? Për blerjen e paisjeve për kompaninë "Eko Theranda" e keni paraparë në këtë kornizë 636.000€. A mund të na informoni se çfarë pune saktësisht kanë me realizu përmes kësaj kompanie? Nuk kam asgjë kundra kësaj kompanie, përkundrazi e kemi përkrah dhe siq e dini ka qenë edhe në program tonin zgjedhor themelimi i një ndërmarrje të tillë por ndarja kaq e madhe e mjeteve për blerjen e paisjeve dhe shpenzimet tjera që do të ketë kjo ndërmarrje, a e arsyeton mjeti qëllimin? A keni bërë analizë për këtë? Tek ndërtimi dhe rikonstruimi i rrugëve lokale në komunë i keni planifiku 1.5 milion për këtë kornizë, a dihet konkretisht ku? Për ndërtimin dhe rregullimin e varrezave në Biraq i keni 908.400€, a mund të na sqaroni se çka do të investohet aty? Shpresoj që ky keqplanifikim e ky keqprojektim buxhetor të mos pasqyrohet në buxhetin e vitit 2015 sepse ky nuk është buxhet për qytetarin por është buxhet tipik për fushatën elektorale të vitit 2025 dhe ne do të mundohemi me të gjitha mekanizmat që i kemi që mos ta lejojmë një shpërdorim të tillë të parasë publike që po provoni të bëni me këto akrobacione.

**Kryetari** - unë do të mundohem të përgjigjem në të gjitha pyetjet që keni bërë. Korniza buxhetore për tri vitet do të vendosen emrat në muajin gusht për arsye se jemi duke punu projekte dhe qëllimi kryesor është se po ndodh që po kalojnë emrat në muajin qershor dhe rrugët që janë të parapara për këtë vit nuk po kryhen për shkak të OSHP-së dhe po shkojnë dy kode po bëhen pa u kry asnjë rrugë. Procesverbalet që janë mbajtur nëpër fshatra mund ti shihni në faqen e komunës ku i keni publike. Dëgjimet publike lajmërohen dy javë përpara dhe ata që kanë qenë të interesuar me ardhë, kanë ardhë mirëpo ato propozime që i kanë dhënë fshatrat, ato emra kanë me u vendos. Pyetët për projektin e rrymës. Është një kontratë nëse nuk gaboj 2.2 milion euro, ka garancion 10 vite. Në Vraniq vitin e kaluar me 1 gusht janë ndërru komplet dritat dhe në bazë të analizës që është bërë, afërsisht 50 % me dritat e reja që po vendosen paguajmë më pak. Nuk ka mundësi për një vit me u përfshi 42 fshatra. Projekti i varrezave kushton 5 milion euro, nuk e kam bërë unë projektin dhe nuk kryhen me 200.000€ dhe as me 400.000€ dhe këto shkojnë me procedura të prokurimit. I cekët impiantet e ujërave atmosferike. Janë të parapara për dy vite dhe janë duke u punu projektet. Nuk ka mundësi një impiant m'u punu pa projekt dhe qëllimi është që çdo vit me shku dy ose tre fshatra. Këtë vit jemi mundu që të gjitha punët që kryhen nëpër fshatra me qenë me projekt dhe këto na marrin kohë. Kjo është kornizë, në shtator vijnë emrat e rrugëve komplet. Për fat të mirë këtë vit kanë ndryshu çmimet dhe nuk kanë hy me çmimet si më herët 8 € m<sup>2</sup> i kubëzave dhe 8 € është m'i ble por çmimet janë më të mira dhe besoj që punët kanë m'u bo ma t'mira. E dini problemin e rrugës së Reshtanit. Kemi zbatu urdhëra, kemi prit përgjigje dhe jemi në rregull. Te rruga te sheshi: kanë qenë para të planifikuara dhe s'kan dal ende por paratë tona i shpenzojmë. Ne kemi marrë mjete mjaft shumë nga qeveria aktuale dhe do të marrim për arsye se kërkojmë pjesën tonë. Mos e merrni tragjike sepse unë e di që duhet me fol diçka dhe mund të flisni por s'kemi vendos emra të rrugëve. Procesverbali i dëgjimeve publike është vendos në faqe të komunës dhe ato kërkesa kanë me hy në buxhet.

**Laureta Tafaj** - për mua personalisht kjo thënia jote: këta duhet me fol diçka, është ofendim. Tu kisha lut me tërheq.

**Urim Suka** - pak a shumë ne jemi mësu që del Kryetari këtu dhe gati s'na kthen përgjigje për asnjë gjë që folëm ne. Për shkak të OSHP-së nuk i qesim emrat sepse mund të jetë procedura në OSHP, tha Kryetari. A për krejt fshatrat i ke në OSHP? Është përgjigje e pa përgjegjshme sepse nuk janë krejt fshatrat në OSHP dhe nuk është arsye kjo. Po thua që keni mi vendos emrat në shtator. Unë nuk e paragjykoj çka kemi me bo në shtator, unë po flas për kornizën që m'ka ardhë tash. Unë thash 300.000€ i ke planifiku për rrymë për

vitin 2025, Kryetari nuk foli për këto 300.000€ por tha që për projektin e rrymës e kemi një kontratë 2.2 milion euro për 10 vite.Nëse ti i ke 2.2 milion një kontratë,çka t'kanë vy edhe 300.000€ me i planifiku?Pyetja ishte se a mundemi këtë planifikim me specifiku.Nuk më dhe përgjigje për impiantet.A do të kryhen për këto dy vite këto impiante?Sa shumë kërkesa të Bllacës adresova dhe për asnjërën nuk më dhe përgjigje.Korniza që e ke sjell është për keqardhje dhe kërkesa ime është për juve,jo si një diçka mos ta votojmë dhe ta ndëshkojmë.Andaj unë po them mos ta votojmë dhe pas një jave ta votojmë nëse e përmirësohet sipas standarteve minimale që duhet m'i pas.

**Selman Kolgeci** - kur është votu buxheti i vitit 2024 të kam thënë që edhe mini impiantet kanë qenë pjesë e programit tonë zgjedhor.Nëse nuk të kujtohet ftoj procesmbajtësen që në këtë proces me fut edhe debatin që e kemi pas për këto impiante kur unë të kam thënë që këto impiante ti nuk je i gatshëm në vitin 2024 n'këtë faze m'i bo për shkak se nuk ke bo as debat publik me qytetarët e Sllapuzhanit dhe as të Dubravës për vendin ku kanë me u ndërto këto miniimpiante.Ke thënë: e kam kry,e tash po thua duhet shpronësim.Të kemi thënë që duhet fillimisht projekt dhe ke thënë që e bëjmë edhe këtë.Për këtë dhe shumë tjera kemi qenë kundër atij buxheti që e ke votu për vitin 2024 që tash rrezikon mos me mujt me realizu ato dy projekte. Te ndriçimi në Vraniq është e vërtetë që i ke ndërru por shqetësuese është që tjerat që kanë qenë aty dhe që kanë pas garancion,kush i arsyeton?Të kam thirrë disa herë me rregullu ndriçimin,e keni në kuadër të garancionit të punimeve që jep kompania por nuk jeni përgjegj dhe jo vetëm për këtë por edhe për shumë fshatra tjera që keni zgjeru rrjetin dhe nuk i keni riparuar defektet që janë paraqit pas dorëzimit të projektit.

**Liridon Fandaj** - unë desha ta përgëzoj Kryetarin që tash po i vlerëson investimet që qeveria po i bën për komunën e Suharekës sepse kur është nda buxheti krejt asambleistat e AAK-së kanë thënë që na ka diskriminu qeveria Kurti por kam mendu që edhe Urimi ka kalu në Aleancë sepse edhe ky e kish bë të njejtin postim e tash po del që komuna e Suharekës është mbështet më së shumti prej krejt komunave nga qeveria Kurti.

**Festë Kabashi** - dua të ndërlihem te pjesa e investimit te shkolla "7 Marsi".E kemi pa që ka qenë e përfshime në buxhetet e viteve paraprake dhe poashtu u përmend nga Laureta dhe Urimi.Përgjigje nuk morëm nga Kryetari ndoshta pa dashje dhe nëse mundet Kryetari ose Drejtori i Arsimit me na tregu pak më saktësisht se kur pritet me fillu si investim dhe çka saktësisht?

**Kryetari** - vitin e ardhshëm fillojmë shkollën pasi që është një shkollë që punohet me dy ndërrime.Nëse na ndihmon ministria,mirë dhe nëse jo,ne kemi parapa në kornizë me ndërto një shkollë të re.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 2.

**16 për,10 Kundër,1 apstenim  
Miratohet Pika 2**

### **Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për caktimin e vlerës së bonus banimit;**

**Kryesuesi** - e elaboron pikën dhe hap debatin.

**Laureta Tafaj** - kisha pas kërkesë dhe kërkoj mbështetje prej kolegëve.Nëse ka mundësi që ky numër të rritet në 15 për arsye se besoj që këto banesa kanë me u dhënë për gra që janë nëna vetushqyese ose për raste shumë sociale dhe të bëjmë një numër pak më të madh të tyre.

**Sanie Kuçi Rexhepaj** - në bazë të raportit që ka dorëzu Drejtoresha e shëndetësisë dhe që e falemderoj,nga raporti shihet që dy gra nuk kanë nënshkruar kontratën për x arsye të ndryshme.Çka ndodh me ato dy vende të lira të cilat ne si kuvend i kemi votu për me përfitu 10 përfitues-e,a rishpallen përsëri apo ka ndonjë kompetencë tjetër komisioni?

**Besa Kuçi** - siq e keni pa në raport dy persona që kanë qenë përfitues nuk kanë arrit me nënshkru kontratën për shkak të ligjeve të cilat kërkojnë që qeramarrësi dhe qiradhënësi me pas një marrëveshje paraprakisht pastaj pas marrëveshjes nënshkruhet marrëveshja me Kryetarin dhe ato dy vende kanë mbet të lira.Në praktikën e kaluara i kemi shpall mirëpo nuk ka apliku askush dhe si procedurë ka shku deri si në fund të vitit dhe e shihni në raport që procedura ka përfundu për shkak të afateve ligjore dhe nëse e

shpallnim prap hynim në oligime.Kam bisedu me komisionin dhe kanë rekomandu që të shkojmë vetëm me këto kontrata që janë nënshkru.

**Sanie Kuçi Rexhepaj** - si çështje e kemi diskutu edhe në mbledhjen e KPF-së duke u bazu në programin e veqantë të banimit i cili nuk ka mandat më.A planifikon komuna me hartu një program të ri të banimit?Duke u bazu në atë program është planifiku që me qenë 20 përfitues në vit për bonus të banimit ku gjithsej 15 përfitues i përzgjedh komisioni në bazë të thirrjes publike dhe 5 janë atëhok që merr kompetencë nga kuvendi komisioni në raste të ndryshme tragjike.A mund të ndodh edhe kjo që kur po lirohen dy vende,me ja dhënë kompetencën komisionit që me bë zgjidhje dhe jo me rihap thirrje të tjera të cilat po shkojnë deri në fund të vitit dhe komuna po hyn në obligim tek vitin tjetër për atë subvencionim.

**Besa Kuçi** - sipas informacioneve ligji veq është duke u përfundu dhe në momentin që na vjen diçka më konkrete atëherë do të veprojmë.

**Kryetari** - për mua mund ta bëni numrin jo 15 por 20.Vitin e kaluar ka qenë i hapur dhe kanë konkuru 8 dhe kemi një problem që kur ta vendos asamblea 10 dhe në qoftëse nuk e marrin 10,në performancë marrim minusa mirëpo duhet ti përmbahemi kushteve të parapame.

**Besa Kuçi** - për mendimin tim mund ta rrisni edhe 15.Në bazë të ligjit veprojmë, buxhet ka dhe mbetet në vullnetin tuaj.

**Bulëza Kuçi** - Ne jemi të vetëdijshëm që bonus banimi është një politikë e rëndësishme sociale që mund të ndihmojë në përmirësimin e kushteve të jetës dhe stabilitetit ekonomik për familjet dhe individët në nevojë.Për të qenë efektiv është e rëndësishme që programi të jetë mirë i planifikuar,i financuar në mënyrë adekuate dhe i monitoruar rregullisht për të siguruar që të arrijë qëllimet e tij.Ne jemi përkrahës të kësaj iniciative por i kemi disa vërejtje ku raportin nuk është i detajuar mirë dhe kemi frikë që mos po hasim në mos barazi.

**Urim Suka** - ne si LDK e kemi kërku në KPF që ky raport me na ardhë me qëllimin që këto para të shkojnë në vendin e duhur sa më mirë.Te diskutimi që Bulëza e pat që raportin me qenë sa më i detajuar,ne e kemi diskutu edhe në KPF që aty janë 10 që i kanë plotësu kriteret dhe 8 kanë marrë.Nuk e dime secili person çfarë kontrate ka,a e ka kontratën 500€ ,a e ka kontratën 100€,a e ka 200€ ? sepse nëse unë konkuroj dhe arrij ta bëj kontratën 500€,më bje me i marrë 250 euro por dikush që nuk ka arrit me rrit këtë vlerë të kontratës dhe e ka një kontratë 180€ ndoshta,atij i bie 90€ me mbështet dhe këtu është një lloj pabarazie.Për me nal këtë pabarazi kemi dasht me pas një raport se sa ekziston kjo pabarazi edhe pse nuk duam të paragjykojmë por ju nuk i keni sjell këto të dhëna.Ju rekomandojmë që këtë pabarazi nëse ekziston,është mirë të merrni masa dhe të ndalohet.Uroj që vitin e ardhshëm ta sjellni raportin më të detajuar se tash.

**Besa Kuçi** - ai ka qenë raport ku ka punu komisioni në të dhe sa i përket kontratave është në kompetencën e qiramarrësit dhe qiradhënësit që i bëjnë kontratat sipas ligjit te noteri.Kontratat tjera mes qiramarrësve dhe Komunës bëhen te Kryetari,pra nuk bëhen në drejtori.Te ne vin dhe bëhet vlera për pagesë në bazë të kontratave që i kanë bë me zyrën e Kryetarit.Edhe unë jam e pajtimit për atë që thua ti megjithëse ka dallime por ato janë kontrata në kompetencë të tyre që i bëjnë por nuk e di ne a kemi kompetenca ligjore me ndërhy te qeramarrësi dhe qeradhënësi se çfarë kontrate bëjnë.Zyrtari ligjor mund të na interpretoj se a ka ndonjë udhëzim që e rregullon këtë.Për raportin më të detajuar që po e kërkoni,mund ta përgadisim sepse çdo gjë është transparente.

**Urim Suka** - qëllimi jonë është që kjo ndihmë me shku proporcional te krejt familjet.Ju kisha lut ta keni parasysh në mirëbesim këtë pjesë që mos ti jepet dikujt ndihmë tepër e madhe dhe dikujt shumë e vogël brenda asaj që keni bazë ligjore me rregullu.

**Avni Bytyqi** - atë që e thotë Urimi e thotë edhe ligji. Ligji e thotë decidivisht që 50% të vlerës minimale të qerasë u jepet bonus banimi.Kështu që dikush e ofron kontratën 500€, dikush 200€ dhe vlera minimale është 200€. Nuk merret vetëm një kontratë por merren 4-5 kontrata mostër.

**Urim Suka** - pikrisht duke i pa këto që thotë Avniu unë e kam kërku një raport me kontratat dhe me ditë secila familje sa ka marrë mbështetje me qëllimin e vetëm me nal pabarazinë nëse ekziston.Për deri sa s'e kemi raportin me detaj ne ende kemi hapësirë me paragjyku dhe drejtoresha gati e konfirmoi që dikush ka marrë ma shumë e dikush ma pak.

**Besa Kuçi** - pyes zyrtarin ligjor se a është kompetencë e komuës me ndërhy te kontratat e qiramarrësit dhe qiradhënësit të cilët i bëjnë te noteri ato kontrata.

**Avni Bytyqi** - në asnjë mënyrë nuk ka të drejtë të ndërhyjë te çështja e caktimit të çmimit për asnjë produkt. Çmimi në treg është i lire por përgjegjësia e komisionit është që të merr mostra te dy-tre noter dhe ta krahason vlerën minimale ku po ndalet dhe ajo vlerë minimale, merret dhe subvencionohet për 50%. Te çështja e rang listës, e tha edhe Kryetari dhe drejtoresha që komuna ka mundësi me subvencionu edhe për 15 familje dhe 20 familje por e keqja është që nuk po aplikojnë. Zyrtari ligjor tutje jep sqarime.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 3 me propozimin e Lauretës që bonus banimi të rritet për 15 familje.

## Unanimisht Miratohet

### Pika 4.

**Kryesuesi** - e elaboron pikën dhe hap debatin.

**Qëndrim Elshani** - çfarë plani të hollësishëm rregullues? Një fshat turistik brenda fshatit turistik! Ne si LVV dhe asnjëri prej neve këtu besoj që nuk jemi kundër zhvillimeve të turizmit madje jemi shumë pro zhvillimit të turizmit mirëpo jemi kundër mënyrës se si doni me bo këtë hap. Kënd po doni me pasuru? M' duket një Suharekë p' e dinë. I keni nda njëherë parcelat dhe e keni ditë saktësisht në cilat parcella keni me investu por Ministria ju ka kthy mbrapsht. Duhet me pas parasysh që investimet aty kanë m'u bo me taksa të qytetarëve andaj Kryetar duhesh me qenë më i drejtë dhe jo si ja ke bo me sheshin, me rrënimet e objekteve aty që ke qenë shumë selektiv. Të njejtën praktikë je tu dasht me bo edhe në Delloc. Kjo është shumë e dëmshme për komunën e Suharekës andaj besoj që edhe kolegët e opozitës e dine shumë mire këtë punë dhe kërkoj prej të gjithëve m'u votu kundër ky plan rregullues në këtë formë që po na vjen në Kuvendin Komunal.

**Sanie Kuçi Rexhepaj** - është hera e tertë që një vendim i tillë po sjellet e risjellet në kuvend. Herën e kaluar Ministria ka kërku që të gjitha parcelat me qenë pjesë e projektvendimit, tash e ka kthy prap dhe e ka kërku një skicë. I jap të drejtë Ministrisë që e ka kërku për shkak se prej fillimit kam qenë insistuese që secilit inicim të procedurave me i bashkangjit një hartë e cila na sqaron qartazi ku është ajo zonë që komuna planifikon me inicim këtë plan rregullues dhe gjithëashtu një planprogram që në këtë rast po mungon dhe i cili i përmbledh se cili është qëllimi i komunës dhe cilat janë objektivat e komunës që komuna planifikon me i realizu ato qëllime. Tjetër që po mungon është një prezantim nga ana e Komunës që na sqaron se ku është zona, çka po planifikohet me u realizu përmes këtij plani, si do të shkoj procesura, si e parasheh ligji? Pra janë disa çështje të cilat ndoshta në përgjithësi unë si Sanie i di por gjysma e asambleistëve me plot të drejtë nuk e kanë të qartë se çka do të thotë një inicim i kësaj procedure. Këto mungesa na kanë sjell në këtë pikë ku që tri a katër herë po na risillen nga ana e ministrisë një projektvendim i tillë. Me u marrë parasysh rekomendimet e kuvendit sa po merren parasysh tash rekomandimet e ministrisë, besoj që kishim qenë duke e realizu këtë plan rregullues të hollësishëm. Një plan i tillë planifikohet për 8 vitet e ardhshme dhe jo në çdo asamble, në çdo vit nuk vjen përveq prejashimisht në këtë rast që na ka ardhë tre-katër here për shkak se serioziteti në plane rregulluese është zero.

**Selman Kolgeci** - kjo çështja e planit rregullues ka fillu me na ardhë aq shpesh për plotësim-ndryshim sa që po na duket si procesverbal. A është hera e fundit që ka me ardhë Delloci për votim? Kërkoj me qenë konkret drejtori Kuçi në këtë pyetje. E dimë që hartimi i këtij plani të hollësishëm rregullues derivon prej HZK-së sikurse disa plane tjera rregulluese që do të duhej të miratoheshin për disa zona të caktuara të paraqitura në HZK por zgjatja në kohë vetëm për Dellocin është një tregues që edhe në hartat tjera mundet me pas pengesa dhe vonesa të njejtë. Drejtor Kuçi ju lutem që ti trajtoni me shumë kujdes këto dokumentacione. E kuptoj që mund të mos jetë e lehtë për ju që po i kthen Ministria prapa por në shkresën e ministrisë ata po i referohen një rregullore, të njejtës rregullore që do të duhej ti referoheni edhe ju. Shkoj qereku i afatit të vlefshmërisë të HZK-së dhe ne kemi telashe ende me këtë plan rregullues. E kemi thënë që ne jemi pro me hartu sa ma shumë plane rregulluese në mënyrë që me kriju sa ma shumë



investimin por ju lutem të jeni më serioz në trajtimin e këtyre dokumentacioneve në përpilimin e këtyre dokumentacioneve.

**Visar Kuçi** - është fakt që plani rregullues i hollësishë në Delloc ka qenë vitin e kaluar në Asamble dhe është aprovuar nga ju. Kur e ka kërku plotësim-ndryshimin Ministria, në përgjigjen që na ka kthyer ministria ka thënë: shënimi të gjitha parcellat e planeve rregulluese. Ka qenë plani rregullues i zonës në Shirokë, zonës në Duhël dhe zonës në Delloc. Duke pas parasysh që kemi pas shumë ngarkesë dhe është dasht më shumë me punë për planin rregullues të Dellocit, atëherë ne si drejtori e kemi tërheq Dellocin dhe kemi vazhdu me planin rregullues të hollësishëm në zonën ekonomike në Duhël dhe Shirokë sepse ka pas më pak numra të parcellave. Të dy ato plane kanë kalu dhe e kanë kalu ligjshmërinë ashtu si janë planifiku në PZHK dhe HZK. Është shpall konkursi i projektimit, janë zhvillu procedurat, kanë aplikuar kompanitë dhe është nënshkru kontrata ku dhe jemi duke i zhvillu procedurat për dëgjime publike, matje gjeodezike ashtu si e kërkon procedura. Sa i përket planit rregullues të hollësishëm turistik të fshatit Delloc janë afërsisht 750 ha, është komplet zona kadastrale e Dellocit prejastuar parkun nacional Malet e Sharrit. Edhe herën e kaluar kur e kemi sjell në Asamble, ne e kemi sjell kufirin kadastral të Dellocit dhe i kemi sjell të gjitha parcellat. Ministria në plotësim-ndryshim ka thënë: ndryshone edhe silleni një ekstrakt dhe vendosne edhe malin Sharr edhe pse ne nuk kemi të bëjmë me malin Sharr. I kemi mbajtur 3 ose 4 takime me Ministrinë dhe në takimin e fundit kanë thënë që hiqini tash parcellat dhe lejeni vetëm sipërfaqen. Ne e dime pse e kanë thënë, për shkak se janë me mijëra parcella dhe ata po pritojnë me i kontrollu. Neve si Komunë na kanë dëmtu. Kur është hartu PZHK dhe HZK-ja ne si komunë dhe hartuesi i këtyre dokumenteve ku i ka parapa planet rregulluese të hollësishme, është dasht me i caktu kufijtë kadastral të atyre planeve rregulluese. Rregullorja thotë që në mungesë të kufirit duhet me i caktu ti kufijtë dhe jo rastësisht në KPF e kam tërheq Planin Qendër dhe Hisarin për shkak se kufiri i zonës urbane në qendër është zgjeru dhe rregullorja thotë që në mungesë të kufirit atëherë duhet me marrë zonën që e ke të caktuar kadastrale dhe unë e kam tërheq. I kemi mbajtur disa takime edhe për qendrën paralel me planin rregullues të Dellocit sepse në pjesën tekstuale për planin rregullues të hollësishëm e kemi vetëm një plan. Në qytet e kemi vetëm Hisarin dhe qendrën të HZK-ja kurse në të kaluarën ka qenë Pojata, Hisari, Qendra 1, Kodra, Sillogja, afërsisht kanë qenë 8 plane rregulluese. Për me qenë ne më të sigurtë dhe me qenë më korrekt me qytetarin, i kemi tërheq prej KPF-së deri sa ta bëjmë një zgjidhje me Ministrinë.

**Sanie Kuçi Rexhepaj** - hartuesi gjatë hartimit të PZHK-së dhe HZK-së I ka parapa të gjitha këto plane që ti po i cek por ministria gjatë fazës së kontrollimit të dokumentit na ka thënë qartazi me plot të drejtë. HZK-ja është një dokument që i specifikon të gjitha kushtet e ndërtimit dhe nuk ka nevojë në të gjithë zonën urbane me hartu plane rregulluese për shkak se planet rregulluese janë vetëm në zona specifike ku ka interes komuna, siq janë zonat industriale, fshatrat rekreative turistike. Kur është zonë e banimit si Pojata, Sillogja, Fidanishtja etj. Nuk ka nevojë me pas plan rregullues të hollësishëm për shkak se të gjitha kushtet i specifikon HZK-ja. Është shpenzim i panevojshëm i komunës, shfrytëzim ose angazhim i stafit i panevojshëm me detyrë ekstra shtesë për me hartu një plan rregullues sepse HZK-ja i specifikon të gjitha. Mu duk e arsyeshme me dhënë një sqarim për shkak se në atë kohë kam qenë pjesë e hartimit të këtyre dy dokumenteve jashtëzakonisht të rëndësishme të cilat komuna është duke i neglizhu shumë për shkak se kuvendit nuk i është dhënë raport mbi zbatimin e këtyre dy dokumenteve sepse e ke obligim ligjor që ta jep vet dokumenti që është miratu në Asamblenë Komunale.

**Visar Kuçi** - plani rregullues i hollësishëm është dokumenti që e mbulon edhe HZK-në dhe PZHK-në.

**Sanie Kuçi Rexhepaj** - çka është ma mirë dhe çka është ma keq i nderuar drejtor HZK-ja është miratu në fund, në mandatin kur ke fillu ti. Ajo që e kemi lënë ne si draft, mirë kish qenë me u plotësu nga ana juaj, me dhënë ju kontributin tuaj por ajo çka ne kemi punu direkt ka dal në diskutim publik dhe shqyrtim publik me qytetar dhe në fund u miratu nga Asambleja Komunale. The: zona qendër mirë është me u bo sa është zona urbane. Jo, se për atë arsye ish thirrë zonë urbane dhe nuk ish thirr zonë qendër. Kush po thotë që zona qendër është rrit? Sepse në momentin që zona qendër rritet zvogëlohet një lagje. Këto gjëra janë analizu gjatë fazës së hartimit të këtyre dy dokumenteve. Pse po e kërkoj unë raportin me u sjell në asamble? Jo vetëm që është obligim ligjor por këto shënime që thua që ne si komunë jemi duke i marr se

çka ka të meta, është që me u revidu pas një kohe dhe jo me hartu plan rregullues sepse është e panevojshme dhe nuk ke të drejtë sepse nuk e parasheh HZK-ja dhe PZHK-ja.

**Visar Kuçi** - ose më keqkuptove ose nuk më kuptove. Për me hartu planin rregullues qendër duhet me pas kufirin kadastral ku ke me hartu këtë plan por ne nuk kemi.

**Sanie Kuçi Rexhepaj** - nëse nuk ju përshtatet është çështje tjetër por harta e cila është edhe në faqe të komunës i përcakton qartazi kufijtë.

**Visar Kuçi** - nuk është. Plane rregulluese me HZK-në në qytet e kemi qendrën dhe Hisarin kurse në hartën nr.10 i ke 8 plane rregulluese. Është bënë një lëshim që nuk e ka pa edhe ministria dhe hartuesi. Kur them hartuesi, komuna dhe edhe unë e kam m'ri HZK-në dhe mund të jem edhe unë pjesë e gabimit.

**Qëndrim Elshani** - a kanë qenë këto parcella pjesë e hartës dhe a vazhdojnë me qenë krejt këto parcella pjesë e hartës? A janë krejt parcellat e qytetarëve që janë taman venali të vendit pjesë e hartës për me kriju këtë fshat rekreativ turistik? Disa investime janë duke u bënë në fshatin Delloc, a kanë leje paraprakisht për ato investime që janë duke u bënë?

**Visar Kuçi** - në fshatin turistik Delloc ka ardhë dokumenti për komplet zonën kadastrale, nuk është prejashu asnjë parcellë, prejashuar zonën e mbrojtur të malit Sharr. Unë dy leje i kam lëshu vjet në Delloc ku i kanë plotësu kushtet dhe është pajis pala me leje dhe të tjera nuk ka por edhe mua më brengos ai shqetësim. Selmani pyeti se a ka me na ardhë edhe një herë, edhe unë beso nuk jam i sigurtë se a ka me na ardhë edhe një herë.

**Qëndrim Elshani** - kur ke me marrë masa për këto investimet që janë duke u bënë ilegalisht në fshatin Delloc?

**Visar Kuçi** - nuk i takon drejtorisë sime kjo.

**Shefket Kolgeci** - a jeni në dijeni si drejtorise sa parcella të qytetarëve i ka përfshi parku nacional që ata janë të dëmtuar në këtë aspekt ? sepse po që se është pasuri shoqërore është pak më relaksuese.

**Visar Kuçi** - është ndoshta fshati i vetëm në komunë të Suharekës që prek edhe në parkun nacional dhe ka parcella private. Me parcella nuk e dimë por si sipërfaqe më duket janë rreth 400 ha që prek në pjesë të parkut por nuk i ka prek as sot, as në këtë qeveri, as qeverinë e kaluar. Kjo vijë e parkut nacional Sharr është në të kaluarën. Drejtori tutje jep sqarime.

**Selman Kolgeci** - drejtori tha që nuk e di ka me qenë hera e fundit që ka me ardhë. Drejtor duhet me qenë e fundit për shkak se ju nëse jeni duke na sjell këto dokumentacione veq me na provu a po i shtyejmë apo jo përpara, kjo është shumë gabim. Ata janë referu dikun kur e kanë refuzu dhe e kanë kthyer në rishqyrtim dhe njejtë siq e kanë kthy ata referojuni edhe ju udhëzimeve administrative dhe mos e ktheni më.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 4.

**20 për, 3 kundër, 2 apstenime**  
**Miratohet Pika 4**

**Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;**

**Kryesuesi** - e elaboron pikën dhe kërkon propozimet nga subjektet politike.

**Aziz Bytyqi** - në emër të grupit të AAK-së propozojmë Mimoza Bajraktari.

**Bulëza Kuçi** - në emër të grupit të LDK-së propozojmë Kushtrim Kuçi.

**Dardan Berisha** - PDK propozon Bajram Basha.

**Qëndrim Elshani** - LVV nuk kemi propozim.

**Jehona Rrafshi** - NISMA nuk ka propozim.

**Kryesuesi** - e hedh në votim propozimin e AAK-së Mimoza Bajraktarin.

**15 për, 10 apstenime**

**Kryesuesi** - e hedh në votim propozimin e LDK-së Kushtrim Kuçi.

**18 për, 4 apstenime**

**Kryesuesi** - e hedh në votim propozimin e PDK-së Bajram Basha.

**17 për, 9 apstenime**

**Pas numërimit të votave Kryesuesi konstaton që kalon Kushtrim Kuçi dhe Bjram Basha.**

**Kryetari** - nga ekzekutivi Armend Krasniqi, Ardian Kotorri dhe nga shoqëria civile Erëza Muça.

**Kryesuesi** – e hedh në votim komisionin me këtë përbërje: Kushtrim Kuçi, Bajram Basha, Armend Krasniqi, Ardian Kotorri dhe Erëza Kuçi.

**24 për, 1 kundër, Miratohet Pika 5**

**Pika 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e kërkesës 01-Nr-181-30362;**

**Kryesuesi** - e elaboron këtë pikën dhe hap debatin. Pasi nuk ka debat e hedh në votim pikën 6.

**Unanimisht Miratohet pika 6**

**Pika 7. Diskutim për klubin FC “Suhareka” ;**

**Dardan Berisha** - unë e ngrita pikën shitesë për diskutim mirëpo është diskutu dhe realisht i kam dy propozime që të gjithë shefat e grupit të përfaqësuesëve politikë të diskutojnë sëbashku me ekzekutivin, në këtë rast me Kryetarin e Komunës dhe dy presidentat e klubit sa më shpejt dhe me gjetë një zgjidhje ose nëse kemi mundësi me ndërhy te rregullorja dhe me nxjerr një akt nënligjor i cili e shton që përveq lojërave ose ndeshjeve futbollistike zyrtare aty të përfshihen të gjitha aktivitetet sportive ku përfshihen lojërat miqësore, stërvitjet dhe të gjitha.

**Alban Berisha** - besoj që këto lloj kërkesa kemi me pas më shpesh dhe ndoshta është më mirë me u mundu më shumë edhe Kryetari në zgjedhjen afatgjate të këtyre problemeve. Uroj që mos t'ketë edhe rivalitete personale mes dy ekipeve sepse rivalitete sportive pres dhe është shumë e shëndosh me pas dhe është e natyrshme që ka me pas. Nuk kemi nevojë ne këtu për kërkesat tona që i sjellim, me marrë dikush një konutacion tjetër, me thënë ti je kundra Suharekës ose kundra Ballkanit sepse ne këtu e përfaqësojmë qytetarin dhe ne jemi pro sportit. Ne mundemi me hy me ndërresa të ndryshme dhe me simpati të ndryshme nëpër ekipe deri te dera e asamblesë por kur të hyjmë këtu ne nuk e përfaqësojmë dhe as simpatizojmë asnjërin prej ekipeve të Suharekës por jemi të obliguar me i ndihmu me gjetë zgjidhje. Mendoj që zgjidhja që kërkoi Dardani është shumë e frytshme por për një afat shumë të shkurtë. Privatisht në aktivitete sportive me Kryetarin e kemi diskutu punën e një stadium të ri. Po flas në emër të grupit partiak sepse e di çka mendojnë secili prej tyre për sport. Atë ditë Kryetar që e ke një zgjidhje për një stadium të ri, absolutisht me krejt kapacitetet tona, ne jemi mbrapa me bo një zgjidhje. Përveq rivalitetit sportive ne e kemi obligim me bo çmos që mos me kalu edhe rivalitet personal mes dy ekipeve. Nuk është vetëm problemi i stërvitjes dhe problemi i lojës me një fushë por ka me qenë edhe aspekti i reklamave. Ne e kemi të njejtin problem në palestër. Edhe pse janë sporte të ndryshme p.sh dikush investon në basketboll, i bëhet reklama në volejball ose në një sport tjetër ose e kundërta. Uroj që kërkesa e Dardanit me shku përpara. Ne jemi mbrapa por kjo është për mua një zgjidhje shumë afatshkurtër. Kryetar, të lus ta marrësh shumë më seriozisht. Nëse nuk munesh me bo një stadium të mire për lojëra, të paktën një stadium të mire për ushtrime mujna me majt dhe besoj që do të ishte zgjidh shumë lehtë problemi.

**Liridon Fandaj** - e mbështes atë që e tha Dardani. Është mire me u taku me dy klubet dhe me gjet një zgjidhje. Përndryshe unë kisha propozu që, pasi klubi i Ballkanit nuk iu ka përmbajt kontratës, është mire me shkëput kontratën dhe në menaxhim stadiumin me marrë Drejtoria e Kulturës. Drejtoria e Kulturës mund ta bëj një orar për secilin por jo me pas ndasi sepse ne ia kemi dhënë një të drejtë dikuj që nuk e ka respektu as kontratën e vet dhe sot ai e cakton kur të don, kur e ka të lirë fushën. Andaj me mujt me gjet një zgjidhje do të ishte shumë më mire por nëse ai nuk iu ka përmbajt kontratës, unë mendoj që duhet me iu shkëput kontrata.

**Kryetari** - është e vërtetë që unë i kam taku disa here, kanë pas marrëveshje me gojë ashtu siq parashihet në rregullore që asnjëherë nuk ka mundësi klubi i Ballkanit me ia lënë ose mos me i lujt FC Suhareka kur

ka lojë zyrtare.Me klubin e FC Suharekës e kanë bërë një kërkesë për stadiumin në fshatin Samadraxhë që ndoshta i plotëson kushtet për ushtrime dhe për gjëra tjera më mire se i Ballkanit.Dje i kam thirr klubin FC Suhareka dhe i kam kërku dokumentet sepse pa dokumente nuk bëhet.Ne e kemi kriju një komision dhe në bashkëpunim me federatën dhe me ta që federate me marrë përsipër dhe stadiumin ndihmës me bërë në Studenqan.Ashtu si e jep ligji kemi me startu.Ju e dini që Ballkanin e kemi stimulu aq sa kemi pas bazë ligjore por më nuk kemi mundësi asnjë cent me i ndihmu.Klubit tjetër i kemi ndihmu me 15.000 ose 17.000€ dhe tash janë nda subvencione 32.000.Pra edhe ky afërsisht ka mrrri te 50.000€.Klubi i FC Suhareka mund të merr pare prej Komunës edhe 500 vjet sepse është OJQ.Të gjithë ata që kanë tatim në komunë unë edhe me dasht nuk mundem me ia hek.Tash i kemi njoftu të gjithë dhe mbas një muaji shkon te përmbaruesi dhe ne obligimin tonë e kryejmë.Këtë vit nuk kemi tatim,tatimet i kemi fal.

**Liridon Fandaj** - unë nuk jam idhëtar i atyre që dua ti fus në konflikt dy klube.Tatimi në pronë është fal por jo tatimi në qera.Nëse neni 3 e thotë që ai me 5 të vitit të ardhshëm duhet me pagu atëherë ai e ka shkel vet kontratën.Kështu që, ti mund ta qosh në përmbarues por nëse nuk e përmban kontratën si qeramarrës,je i obliguar t'ja shkëputësh kontratën.

**Kryetari** - thashë me lidh tatimin në pronë,vitin e kaluar është fal në komunën e Suharekës dhe ne e kemi problem me mrrri kuotën që është e paraparë 2.4.

**Kryesuesi** - a doni me caktu një takim sëbashku pasi e kërkoje ti Dardan.

**Dardan Berisha** - e presim kryetarin deri sa të na fton neve shefave.

**Kryetari** - Kryesuesi le ti fton klubet dhe juve.

**Dardan Berisha** - kryesuesi iu ka drejtu ekzekutivit.

**Kryetari** - ekzekutivi e zbaton ligjin që është në fuqi.

## **Pika 8. Pyetje dhe përgjigje**

**Elmaze Bytyqi** - pse nuk po funksionalizohet rentgeni i dhëmbëve kur dihet që aparatura është blerë afro 4 vite dhe po rrin nëpër depo ndërsa qytetarët detyrohen të marrin shërbime nëpër institucione private?

Pse nuk po punon ndriçimi publik?U fol për ndriçimin publik dhe gati të gjitha fshatrat e kishin të njejtin problem dhe edhe fshati Kastërrc tash e disa muaj nuk ka ndriçim publik.

**Besa Kuçi** - me sa e di rentgeni i dhëmbëve është model që fotografon vetëm një dhëmbë me film dhe tash stomatologët po kërkojnë fotografimin e gjithë nofullës por gjithësesi do t'ia drejtoj menaxhmentit si pyetje dhe në momentin që marrë përgjigje do t'ua kthej.

**Enver Shabani** - ndriçimi publik dikund funksionon shumë mirë dhe dikund nuk funksionon.I mungon mirëmbajtja.Kompania që e ka një kontratë mbi 2 milion euro thotë që nuk ka furnizim.Jemi në pritje dhe në momentin që ata janë të gatshëm me punu,ne jemi të gatshëm me ekzekutu.

**Jehona Rrafshi** - seancën e kaluar kemi marrë një vendim për ti ndihmuar familjes në fshatin Bllacë të cilit i është djeg shtëpia.Drejtoria e Kulturës dhe e Bujqësisë ka pas subvencionimin në bazë të kodeve që është parapa me iu nda.Pse ende nuk është ndihmu kjo familjet?Ku janë me procedure për ndarjen e këtyre mjeteve?Gjithëashtu i drejtohem drejtorit të Bujqësisë:më ke thënë që të hënën ke me ardhë në Duhël për ta vizituar një çështje të kanalizimit dhe nuk ke ardhë.Për të njejtën është bisedu edhe për kanalizimin dhe rrugën "Atlantida" në Bllacë dhe nuk ke ardhë.Kur do të vjen ti vizitojmë këto probleme?

**Lorika Gashi** - Drejtoria e Kulturës e bën vetëm bartjen e parave dhe për më shumë informata ne nuk kemi të bëjmë me këtë subvencionim dhe besoj që Drejtori Shërbimeve Publike duhet me tu përgjigj.

**Jehona Rrafshi** - kur do të bëhet bartja dhe a është bërë deri tash?

**Avni Bytyqi** - është e vërtetë që është marrë ky vendim muajin e kaluar dhe ne e kemi prit konfirmimin e ligjshmërisë prej Ministrisë së Financave.Dje unë ia kam dhënë Drejtorisë së Bujqësisë vendimin dhe sot ia kam dhënë Drejtorisë së Kulturës dhe këta tash e tutje kanë për obligim ti zhvillojnë procedurat për ti zotuar mjetet dhe mjetet lëshohen drejtë për së drejti në gjirologarinë e tij dhe DSHPE nuk ka të bëjë asgjë me këtë.

**Jehona Rrafshi** - ajo që është e rëndësishme është që duhet urgjentisht dhe ta keni parasysh.

**Ardian Kotorri** - siq e tha edhe Avniu,unë dje e kam kryer si procedurë dhe e kam përcjell për te Thesari për pagesë.Ne po marrim vendime dhe është mirë ti ndihmojmë secilit mirëpo duhet ta kuptoni që po e

lëmë mangu një projekt të rëndësishëm dhe realisht drejtorja po minusohet dhe duhet ta keni parasysh këtë. Asambleistja e ceki që nuk kam shku unë por edhe unë e kam agjendën bukur të ngarkuar kështu që është mirë me cek që sa herë ju kam përgjigj edhe shumë punë që i kemi kry.

**Jehona Rrafshi** - ke qenë menaxher i kontratës dhe për atë tu drejtova. Përgjigja dhe dalja në teren janë dy çështje të ndryshme dhe të falemderoj sepse ke qenë i gatshëm por ajo që është kërku nuk është kry.

**Dorentina Zenelaj** - kam marrë shqetësime nga qytetarët në lidhje me rrugën Sopijë-Vraniq. Këto shqetësime qytetarët i kanë paraqit përmes fotografive ku vërehet që asfalti i shtruar para tre-katër dite është i dëmtuar. Kërkoj të dilni në teren dhe të kërkonin nga kompania që ti evitoj këto dëmtime dhe dua të informohem se kur do të përfundoj ajo rrugë.

**Enver Shabani** - një nga këto fotografi i kam marrë edhe unë. Kontrata e ka një menaxher, është arkitekt dhe ai është duke i përcjell në vazhdimësi punimet dhe deri tash nuk ka marrë asnjë pagesë për punën që e ka kry. Pa i përmirësu punët në teren me asfalt ai nuk merr pagesë.

**Liridon Fandaj** - me date 05.06.2024 një paciente në ora 8 ka qenë në QKMF-në në Therandë. Pas konsultës me mjekun ai ka rekomandu ti bëj analizat. Pasi ka bërë analizat prap ka shku te mjeku dhe mjeku i ka rekomandu një bar që mandej kur ka shku në farmaci, bari ka dal të jetë për kafsh specifikisht për qen dhe është detyru të kthehet prap te mjeku dhe mjeku i ka shkru një recetë tjetër pa e pyet se për çka bëhet fjalë dhe i ka shkruar një bar tjetër. Pacientja e ka konsumi mandej ka pas alergji dhe është kthi prap në QKMF dhe nuk është trajtu. Ajo ka shku në polici dhe e ka bë një kallzim për mostrajtim dhe ka shku u trajtu në Prizren. Ajo ka bë një ankesë te drejtoresha dhe nuk ka përgjigje. Dua ta pyes drejtoreshën se cilat janë masat që janë marrë? Pyetje për Drejtorin e Arsimit: Para disa dite është mbajtur një festë në sheshin e qytetit me maturantë, kush ka qenë sponzori i kësaj feste dhe cila është arsyeja që u dasht me festu kur maturantët ende nuk e kanë përfundu testin e arritshmërisë? Institucionet që janë për me festu dhe për me i gju kapelat për një arritshmëri janë institucionet arsimore dhe jo sheshi apo e keni pas për me bë një miting politik sepse ata janë votues të ardhshëm. Pyetje për Drejtorin e Shërbimeve Publike: projektet e aprovuar në buxhetin e vitit të kaluar për fshatin Peqan deri sot asnjëri prej projekteve nuk është tenderu. A do të thotë që në këtë vit ato investime që janë parapa për fshatin Peqan nuk do të kryhen për shkak se gjashtë muaj kanë kalu dhe asnjë projekt nuk është ekzekutu?

**Besa Kuçi** - për një çështje të tillë unë zyrtarisht nuk kam asnjë ankesë në drejtori. Meqenëse ka bo ankesë në QKMF te drejtoresha, besoj që drejtoresha e ka vendos si çështje në këshill dhe e kanë diskutu. Unë pres zyrtarisht me më informu çka ka vendos këshilli. Sa i përket atyre fjalëve, askush nuk e ka testu dhe vërtetu. Mund dikush me fol fjalë të rrugëve por gjithësesi pres raport prej këshillit drejtues. Me sa e di asambleistja Mimoza është në këshill drejtues dhe mund të na informoj.

**Liridon Fandaj** - unë ta thashë shqetësim qytetar dhe jo fjalë të rrugës dhe nëse ti qytetarët nuk i respekton dhe i quan qytetar të rrugës!

**Mimoza Bajraktari** - pacientja është nga Reshtani. Ka ardhë me date 6 në QKMF dhe ka kërku ndihmën mjeksore, e ka marrë ndihmën mjeksore dhe mjeku i ka kërku me bo analizat laboratorike. I ka bë analizat dhe ka ardhë ditën tjetër por nuk ka pranuar të merr shërbim nga mjekët tjerë, gjë që kam qenë vet prezente dhe ka kërku mjekun të cilin ia ka kërku me i bë analizat. I ka shiku mjeku analizat dhe i ka dhënë hemoral për hekur. Kur ka shku në barnatore e ka kërku atë medikament por aty ka gabu farmacistja sepse ka shku inspektoriat shëndetësor direkt në barnatore pas ankesës së qytetarës dhe nëse inspektoriat e kish gjet që gabimi vërtetë ka qenë i mjekut, mos memndo që nuk vje në QKMF dhe nuk denohet mjeku. Mimoza Bajraktari tutje jep sqarime sa i përket rastit dhe thotë që nuk ka shanca që ai bar të jetë i qenit sepse e kemi gjet, e kemi hulumtu me protokol e të gjitha. Jemi mbledh si bord, e kemi hetu krejt dhe nuk ka asnjë gjetje që mjekët janë gabim. Janë deklaruar edhe mjekët, janë edhe kamerat dhe mund ti kthejmë kamerat. Medikamenti që e ka shkru, as nuk është përdor dhe as nuk ka qenë i qenit. Aty ka qenë gabim i farmacistit. Pacientja përgjigjen e ka marrë prej bordit të shëndetësisë.

**Liridon Fandaj** - ajo ka raport që alergjia i ka ardhë prej atij bari që e ka përdor.

**Mimoza Bajraktari** - jo, për 2 min. nuk u ble bari dhe nuk është pi. Ajo ta ka dhënë një keqinformim.

**Remzi Bajselmani** - DKA nuk ka qenë organizatore e asaj ceremonie.

**Liridon Fandaj** - Drejtor unë të kam pa ty aty duke fol.

**Remzi Bajselmani** - kam qenë pjesë, nuk kam fol.

**Liridon Fandaj** - drejtor ti ke përgjegjësi.Në shesh nuk mbahet ceromia mi heq kapuqat për një sukses.

**Remzi Bajselamani** - nuk ka qenë zyrtare ajo.

**Liridon Fandaj** - llogon e komunës e ka pas aty.

**Enver Shabani** - sa i përket projekteve për vitin 2024 për fshatin Peqan,ju duhet ta keni parasysh që komuna e Suharekës i ka edhe 42 fshatra të tjerë dhe nuk do të thotë domosdoshmërisht në 6 mujorin e parë me kry ndodnjë punë edhe në Peqan sepse viti kalendarik është deri më 31 dhjetor.Arsye tjetër është që këtë vit është e kontraktune një kompani që bën projektimin e rrugëve andaj keni durim sepse edhe juve ju vjen reni.Buxheti ka me ardhë te ju,nuk keni me mbet pa projekt.

**Liridon Fandaj** - në raport të prokurimit disa nga projektet është dasht të dalin në muajin e 4.Unë pyeta a kanë me u kry projektet dhe a do të kryhen projektet sivjet.

**Enver Shabani** - projektet do të kryhen këtë vit por nuk janë kry të gjitha.Jemi duke shku me përqindje.

**Bulëza Kuçi** - çfarë masa po merren për tu siguruar që parku tek shtigjet e ecjes të mbahet i pastër?A keni ndonjë plan të veçantë për të përmirësuar pastërtinë në këtë zone?Çfarë masa po merren për të kontrolluar dhe reduktuar praninë e gjarpërinjëve në atë pjesë?A ka plan për të përmirësuar infrastrukturën e parkut dhe shtigjeve të ecjes,p.sh. shtimi i kosheve të mbeturinave,ndriçimi dhe stacionet për pushim? Çfarë masa po merren për të siguruar sigurinë e qytetarëve që vizitojnë parkun dhe shtigjet e ecjes,sidomos në mbrëmje dhe gjatë natës?

**Enver Shabani** - ne si drejtori e kemi obligim me bo ndërtimin e shtigjeve të ecjes dhe me i bo funksionale pastaj me mirëmbajtjen e shtigjeve të ecjes janë kompetente të tjerët,në këtë rast një lloj përgjegjësie e ka Eko Regjioni.Sa i përket mbrojtjes nga gjarpërinjtë e ka pas Shëndetësia një projekt me sa di por ne nuk merremi me këtë çështje.Sa i përket ndriçimit është një problem në vete siq e thashë.

**Bulëza Kuçi** - vërtetë është shqetësuese sepse e dini që DKA nuk na lejon që ciklin e ulët nëpër shkolla ta qojmë pak më larg dhe ne jemi detyru dhe i kemi qu atje mirëpo kemi qenë nën stres deri sa e kemi përfunduar atë miniekskurzion dhe është mirë të merren masa.

**Dardan Berisha** - më shqetësoj përgjigja e Drejtorit të Arsimit.A ka pas kërkesë në Drejtorinë e Urbanizmit për shfrytëzimin e hapësirës të Komunës?Nuk mund të thotë drejtori që unë nuk kam të bëj asgjë sepse aty janë drejtorat e shkollave të mesme.Brenda kësaj Drejtori i DKA-së duhet që në KKSB me kërku edhe llogari prej shërbimeve policore nëse e kanë menaxhu komplet ahengun.Unë kam edhe video edhe foto që ka edhe nxënës që i kanë shpërnda.Ka pas pije alkoolike dhe lëndë narkotike që janë përdor aty.Për mendimin tim ka qenë një organizim me konvertu në votë.Një drejtor i arsimit që ka të bëj shkolla aty nuk mundet me ik aq lehtë prej përgjegjësisë.

**Lorika Gashi** - ka pas leje për shfrytëzimin e hapësirave publike.Kanë qenë të njoftuar policia e Kosovës që e kanë monitoru gjatë gjithë natës,Drejtoria e Shëndetësisë dhe zjarrëfikësat.

**Urim Suka** - pajtohem me fjalët e Dardanit që tha dhe parafolësve më herët sepse organizimi ka qenë vërtetë i quditshëm dhe përgjigja e Drejtorit është edhe më shqetësuese.Aty ka pas këngëtar,kush i ka pagu ata?Kush e ka bërë atë pagesë për atë organizim.Inicimin ne e dimë.Inicimi është i Kryetarit për atë organizim,nuk ka qenë i fëmijëve.Është përdorje politike e fëmijëve i ekspozuar me një shesh ku mundësitë për me deviju ata janë tepër të mëdhaja dhe drejtori i arsimit thotë që nuk ka qenë pjesë e atij organizimi por në fakt ka qenë në binë.E kuptoj që dikush tjetër e ka bërë por për seancën e ardhshme unë kërkoj një raport për këtë organizim,sa ka pas kosto,kush i ka bo ato financime?

**Selman Kolgeci** - drejtori tha që për ndriçim mos më pyetni sepse sa herë të më pyesni keni me marrë këtë përgjigje.Është një kontratë me vlerë 2.056.000€ që prej asaj kontrate rrjedhin edhe obligimet tjera dhe besoj që nuk duhet me qenë kjo përgjigje.Presim deri në seancën tjetër që nuk kemi me pas nevojë me ngrit këtë shqetësim por kanë me i rregullu krejt intervenimet e nevojshme në rrjetin që e kanë shtri ata.

**Enver Shabani** - edhe ne kemi mendu që ka me u rregullu shumë mirë por nuk ka dal si kemi mendu sepse kompania gjithmonë po thotë që nuk kemi furnizim tash.Dje kemi qenë në Delloc me një ekip,prap janë në Delloc dhe edhe në Dubravë kanë me shku.Njejtë kemi probleme me kompanitë tjera ku punëtorët e lënë punën.E kuptoj shqetësimin edhe të qytetarëve por jetojmë në të njejtin vend dhe të gjithë i kemi afërsisht të njejtat probleme.

## **Debat i vitit të kaluar në mes të Selman Kolgecit dhe Kryetarit për kornizën afatmesme buxhetore për vitin 2024-2026,i kërkuar nga Selman Kolgeci që ky debat të futet në këtë procesverbal.**

**Selman Kolgeci** - kam pyetje për Kryetarin dhe ata të cilët e kanë punuar hartimin e projektit-buxhetor.Mbi cilin kriter i keni nda mjetet për rrugët të cilat janë pjesë e projekcionit buxhetor kur dihet që nuk keni projekte prej asnjërës prej rrugëve?Cila ka qenë formula që i keni kalkulu këto mjete për rrugët dhe objektet tjera të investimeve kapitale?Për fshatin Vraniq e kemi diskutu disa here nevojën e investimit në parcellën e ndarë nga Kuvendi Komunal për varrezat e fshatit Vraniq dhe po e shoh që nuk është parapa në këtë kornizë asnjë euro për këtë çështje.Ju jeni të informuar mjaft mirë për nevojën që ka fshati Vraniq për varrezat.Nuk kërkon investim të madh,duhet pastrim nga shkurret dhe rrethim i rrethojave përgjatë perimetrit të parcellës.Investim i nevojshëm është edhe në kaptazha të ujit të pijes.Pse nuk keni planifikuar mjete për sanimin e ujëmbledhësve?Po ashtu nuk keni planifiku asnjë euro për ndërtimin e këndit të lojërave për fshatin Vraniq.Çfarë obligimi ju ka fshati Vraniq që nuk po jeni të gatshëm që përpos projekteve tjera të investoni edhe në këto dy projekte të rëndësishme për qytetarët.Në fshatin Sopijë keni planifiku 682.405€ për investime në fusha sportive në Sopijë dhe Komunë.Mendoj që është një gabim teknik për këtë kolonë për shkak se investimet në këtë planifikim buxhetor për KAB 2024-2026 sipas këtij projekcioni që e keni përpiluar rezulton se vlera është 200.000€ dhe jo 682.405€ e ndoshta na pasqyrohet edhe në rezultatin final.Ajo që nuk shkon është se është një moskoordinim mes drejtorive.Investimi i lartëpërmendur është investim që planifikohet nga Drejtoria e Shërbimeve Publike e po ashtu Drejtoria e Arsimit ka planifikuar në këtë projekcion buxhetor 250.000€ për ndërtimin e sallës sportive në Sopijë.A mund të jepni sqarime?Për shkollën në Maqitevë i keni planifiku 345.000€ për ndërtimin e aneksit të shkollës”Besim Ndreca”në Maqitevë.Ju lutem,na sqaroni se çka keni me ndërtu në atë aneks?A ka klasë të mjaftueshme në atë shkollë dhe a ekziston projekt për këtë aneks?Me këtë rënie drastike të numrit të nxënësve shumë shpejt kemi me u detyru që nxënësat me i transportu me një shkollë tjetër të afërt e ju po planifikoni aneks të shkollës.Tek vazhdimi i rrugës”Faik Maliqaj” në Dubravë kërkoj nga drejtori të na sqaroj se ku do të vazhdoj kjo rrugë,për sa metra ka me vazhdu dhe ku ka mu nal?A keni projekt për impiantet për pastrimin e ujërave të zeza?A keni lokacion të ndarë dhe a i keni parapa në planifikime hapsinore?Ju nuk keni nda sanjë euro për projektimin e impianteve.Para se me planifiku buxhet për ndërtimin e tyre,është një numër i madh i procedurave.Ndërtimi ipianteve ka qenë në programin qeverisë tonë e ju po provoni me kopju por as me kopju nuk po dini. Sa i përket projektimit,ju nuk keni planifikuar fare projektim për investime.A doni ta shpenzoni prap buxhetin me metodën e juaj të përafërt e me paramasa shabllon ?Bëni punët siq duhet dhe mos keni frikë nga projektimi dhe planifikimi sepse projektimi dhe planifikimi e nxjerr mirë Komunën dhe më serioz ,edhe zyrtarët e Komunës i liron nga presioni që po ushtrohet ndaj tyre me pranë dhe me nënshkru çka është e çka nuk është.Tek investimet në Breshancë e keni një projekt për ndërtimin e Mullirit të vjetër.Ndoshta është një lëshim teknik se nuk mund të ndërtohet Mulliri i vjetër.Sigurisht kemi të bëjmë me ri ndërtim,sivitalizim të Mullirit të vjetër.Me çfarë arsytimi e keni kategorizu si investim kapital këtë investim?Kërkoj nga Drejtoresha e Kulturës që ta vizitojë Mullirin e Loshit në Vraniq e të planifikojë mjete që ta rregulloj parterin dhe hapësirat për rreth mullirit.I keni planifiku 120.000€ për ndërtimin e shtëpive malore mikëpritëse për akomodimin e turistëve.Ku do të ndërtohen këto shtëpi malore?Kush do ti mirëmbaj?Si do të funksionojnë dhe me çfarë kriteri kanë me qenë në shfrytëzim të turistëve?Keni planifiku 600.000€ në instalimin dhe sanimin e ndriçimeve publike në qytet dhe fshatra.A ka Komuna jonë ndonjë marrëveshje me ndonjë kompani apo organizatë për zëvendësimin e trupave ndriçues eficient dhe shpërndarjen e rrjetit?Nëse po,çka përmban ajo marrëveshje dhe cilat janë detyrimet tona ndaj tyre?Ky projekcion buxhetor as për detyrë shkollore nuk i plotëson kriteret.

**Kryetari** - faleminderit për kritikën.Kjo është korniza e parë dhe qarkorja e dytë vjen në gusht dhe është shumë më e saktë dhe në fund të shtatorit është buxheti.Dëgjimet publike janë shpall, janë ,mbajta në aspektin ligjor dhe kush ka dasht me marrë pjesë,ka marrë pjesë.Kërkesat që kanë hy,95 % janë të kryetarëve të fshatrave.Buxhetin jemi mundu me nda në bazë të numrit të banorëve.Dëshira më e madhe është krejt me i kry.I përmendi varrezat e qytetit por ju e dini problemin e varrezave në qytet dhe unë e di që ka edhe nëpër fshatra problem.Është punu një projekt dhe ai projekt kushton afërsisht 5 milion euro.Ne

jemi duke shku fazë-fazë.U përmend edhe Kolektori dhe këtë vit janë të parapara 500.000€.Paret e vitit të kaluar kthehen. Sipas teje Urim,a ka qenë më mirë me shku suficit 500.000€? Kemi kry kontrata dy vjeqare që sot kanë shku në palestra sportive dhe unë e kam marrë këtë vendim.Përgjegjësia bie mbi mua. Kolektori është shpall dhe e ka marrë në mënyrë zyrtare kompania “Famis”dhe do ti presim ankesat 10 ditë.Vitin e kaluar janë kry 4 km kanalizim në fshatin Bllacë,është kry një kullë e dëshmorëve,një shetitore.Për ujë është bërë marrëveshja me Hidro Regjionin.Komuna nuk shpall tender për ujë por është kompania shtetërore me të cilën bashkëpunojmë.Në Maqitevë do të ndërtohet shkollë e re.Më së shumti nxënës kemi në Maqitevë dhe nuk po bie numri,janë 80 nxënës.Selman,në marrëveshjen me Kryesinë e fshatit Vraniq,disa herë kemi thënë që t’ja dorëzoni ujin kompanisë shtetërore Hidro Regjionit siç i kanë dorëzu shumë fshatra tjerë sepse është problematikë me mbajtje mbikqyrje një fshat ujin si është fshati Vraniq.Te varrezat,shumë fshatra kanë nevojë me i rrethu varrezat mirëpo e kemi një vendim të Asamblesë.Gjeje një shoqatë jo qeveritare,mblidhi gjysën e pareve dhe unë të ndihmoj me gjysmën tjetër në aspektin ligjor.Vitin e kaluar e kemi rregullu rrugën për te varrezat në Bllacë.E di që ka shumë varreza në Bllacë mirëpo nuk mundemi krejt varrezat mbrenda një viti ti rrethojmë.Impiantet në fshatin Dubravë rregullohen në bashkëpunim me Hidro Regjionin.Asnjëherë nuk ka pas mjete më shumë.Mjetet po rriten çdo vit duke llogaritur fondin e qeverisë por edhe të hyrat vetanake.

**Selman Kolgeci** - dua të njoftoj Kryetarin se nuk po flas vetëm për fshatin Vraniq.Ne nuk mundemi me shku dhe njerzit tonë me i varros në therra.Jemi duke kërku me i heq shkurret dhe me bo rrethojnë e parcellës.Tek çështja e dhënies në shfrytëzim të ujit,Hidro Regjionit,është në vullnetin e qytetarëve dhe ne nuk mund të vendosim.Sa i përket asaj që për deri sa menaxhohet uji nga një njeri shumë i respektuar në fshat,du me ti kujtu që edhe këto tjerat që menaxhon Hidro Rexhioni s’ka asgjë.A ke ujë në rrugën Xhavit Sylaj?Sa i përket ndriçimit publik,unë e bëra një pyetje por nuk mora përgjigje.

**Takimi përfundoi: 12:40**

**Procesmbajtësja: Dafina Haziraj**